



Prishtinë, 02 shtator 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1398_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 par. 1 nënpar. 1.11, Nenin 4, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 23 dhe Kapitullit VI të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës 01.12.2020 për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C, adresa: Rr. Rexhep Krasniqi, Banesa 9/1, Mati I, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 02 shtator 2021, nxori këtë:

VENDIM

- I. I LËSHOHET Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C, me numër licence ZRRE/Li_71/20 për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 02 shtator 2021 deri 01 shtator 2026.**
- II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.**

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) me datë 01.12.2020 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë



(tregtimit) të energjisë elektrike nga përfaqësues të ndërmarrjes "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C.

- Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duhet dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
 - Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C me datë 02 shkurt 2021 ka njoftuar përmes gazetave palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtisë) me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.
 - Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
 - Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar. Në këtë rast Rregullatorit i është pamundësuar të veprojë në pajtim me Nenin 7 të kesaj rregulle, në mungesë të kuorumit të Bordit, pasi që Neni 25, paragrafi 2 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë parasheh se, citoj: "*Kuorumi për seancat e Bordit është tre (3) anëtarë. Seancat e Bordit mbahen nëse ekziston kuorumi...*". Kuorumi i Bordit është bërë nga data 02.08.2021.
 - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas udhëzimeve të rregullatorit, aplikacioni është konsideruar i kompletuar, kështu që Bordi i Rregullatorit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 - Licenca e lëshuar do të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se **gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 15 të Licencës së lëshuar nga Rregullatori dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.



Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit **ENERGY FINANCING TEAM L.L.C**
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe

Bordi i Rregullatorit:



Ymer Fejzullahu, Kryesues




Selman Hoti, Anëtar



Izet Rushiti, Anëtar



Lutfije Dervishi, Anëtare



Gani Buçaj, Anëtar